

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fqinjët rrëfejnë atentatin ndaj Viktor Bardhit në Mirditë: Makina blu e ndiqte nga pas, dëgjuam breshërinë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/fqinjet-rrrefejne-in-ndaj-viktor-bardhit-ne-mirdite-ma-kina-blu-e-n-i584219
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 07:19:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 07:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a746b2aa041e234fcbab5740c3454c1e084060081bb2c9c1ad33ab4163c7e193
TEKSTI	43e20ac954cfa322346300188c197d9bc8f0a7bb537ad4143c30ddbc7988309e
PAMJA	bce6c71315815cd3b4b61d25de687666e7d69ab9d2bf4d67130e38add3f6b43

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	de19acc7361dd0917c1f5d58231a4afc2df927344f0974bc944a9d880734658
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	06228d72b62d721da89ad9d8f88b641ef39e753d7557342e2aba3a1beafa7f90
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmaU9TuouoiwTpN4nNecxQMcyu59TjNs8nteVzFNNQZ8Qt



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/de19acc7361dd0917c1f5d58231a4afc2df927344f0974bc944a9d880734658>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

UEFA denon Crvena Zvezden dhe Borac Banjaluken pas homazheve per Ratko Miladic Festivali Kombetar i Filmit shqiptar bashkon kineastet dhe publikun Nga inform

Fqinjët rrëfejnë atentatin ndaj Viktor Bardhit në Mirditë: Makina blu e ndiqte nga pas, dëgjuam breshërinë



6 Shtator 2026, 09:45Kronika TEMA



Gazetarja e emisionit "Review", Matilda Braho, ishte në Ndërfushaz të Mirditës, në vendin ku një atentat i mirëorganizuar i mori jetën 65-vjeçarit Viktor Bardhi. Për mikrofonin e Euronews Albania, ajo mori dëshmi nga banorët e zonës të cilët thonë se Viktori ishte një njeri familjar, ndërsa solli edhe detaje nga vendi ku ndodhi atentati.

Viktima ishte nisur për në punë në ujësjellës, por vetëm rreth një kilometër pasi kishte lënë banesën, autorët i zunë pritë në një prej vendeve ku ai shkonte çdo ditë për të furnizuar fshatin me ujë të pijshëm.

Makina tip "Mercedes-Benz" me të cilën udhëtonte Bardhi u bë shoshë nga plumbat, ndërsa 65-vjeçari mbeti i vrarë në vend. Trupi i pajetë u gjet nga banorët e zonës, të cilët njoftuan menjëherë policinë.

Një fqinje tregon se viktima kishte kaluar me makinë rreth orës 08:00, ndërsa vetëm pak minuta më vonë, në të njëjtin drejtim, kishte kaluar edhe një automjet tjetër.

"Në orën tetë ka kaluar Viktori me makinë. Fiks pas tre minutash ka kaluar makina blu që e ndiqte nga mbrapa. I kam parë nga kamerat e sigurisë që kam në shtëpi. Kemi dëgjuar një kismë dhe më pas breshëri", thotë banorja e zonës.

Sipas saj, ishte djali i saj ai që njoftoi policinë pasi gjeti Viktorin pa shenja jete. Ajo e përshkruan 65-vjeçarin si një njeri familjar dhe punëtor.

"Viktori ishte njeri familjar, që punonte për familjen e vet. Na tmerruan. Tre vrasje për një kohë të shkurtër" thotë ajo.

Edhe një tjetër banor i zonës tregon se viktima shkonte çdo ditë në atë pikë për të hapur ujin e pijshëm.

"Vinte për çdo ditë për të lëshuar ujin. U përshëndetëm sot, por po ta dija që do të ishte përshëndetja e fundit, nuk do ta lija të shkonte të lëshonte ujin", thotë banori i zonës.

Fqinji ngre shqetësimin edhe për sigurinë në zonë, duke e cilësuar vendin ku ndodhi atentati si një pikë të rrezikshme dhe të përshtatshme për pritë.

“Ky nënkalim është shumë i rrezikshëm. E kemi diskutuar edhe pa ndodhur vrasja e Viktorit që ky vend është vend prite. Autorët e kanë ditur destinacionin e tij, e kanë ruajtur dhe më pas i zunë pritë, duke e lënë të vdekur në vend”, thotë ai.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[I apasionuar pas maleve, ja kush është 40-vjeçari që humbi jetën pasi ra në humnerë në Lëpushë të Kelmendit](#)

22:30 Kronika / 2 komente

[Pagat e magjistratëve vijojnë të mos ekzekutohen, reagojnë përsëri gjyqtarët dhe prokurorët](#)

20:35 Kronika / 12 komente

"U fsheh në tualet", policia jep detaje nga arrestimi i Jozefin Markut

18:15 Kronika / 4 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.